



PROCESVERBALI

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **22.08.2018**, me fillim në ora **10.15**.
Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përshëndes, Nënkryetarin Fatmir Iska, delegatët e pranishëm në këtë seancë të KPF-së, monitoruesit e KFORIT, OSBE-së, drejtorët e drejtorive dhe të gjithë të pranishmit e tjerë. Kuorum për mbajtjen e mbledhje kemi, Ju paraqes rendin e ditës të paraparë për këtë mbledhje:

REND DITE

1. **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,**
2. **Shqyrtimi i propozim Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore Nr. P-71510067-01271-9, Z.K- Radostë,**
3. **Informatë për Qarkoren e dytë Buxhetore 2019,**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi – E qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës.
Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. **Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

A ka ndonjëri nga ju ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo, e qes në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës të rendit të ditës:

2. **Shqyrtimi i propozim Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore Nr. P-71510067-01271-9, Z.K- Radostë.**

Rumir Zhuniqu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në Drejtorin e Urbanizmit dhe mbrojtje të mjedisit na ka ardhur një kërkesë për dhënie e kushteve ndërtimore nga z. Latif Zena nga fshati Malësi e Vogël, pas shqyrtimit të kësaj lënde ne si drejtori kemi konstatuar se kjo kërkesë për dhënie e kushteve ndërtimore është jashtë zonës ndërtimore ose në kufij të zonës ndërtimore dhe nuk lejohet ndërtimi në këtë pjesë. Ne ja kemi kthyer një përgjigje palës ku kemi kërkuar që të vazhdoj me procedurë, të bëjë kërkesën për ndërrim destinim të kësaj parcele nga tokë bujqësore në tokë ndërtimore. Personit në fjalë këtë parcelë e ka të falur nga vëllai sepse ka fituar një donacion nga fondi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që implementohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë. Të nderuar anëtarë të KPS-së kërkoj nga ju që këtë lëndë ta procedoni për kuvend.

Nënkryetari – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ju japë vetëm edhe disa informata shtesë, këtu kemi të bëjmë me një person të riatdhesuar, i cili një kohë të gjatë ka qenë në Gjermani, po ashtu ka qenë mbi 15 vite i burgosur. Personi në fjalë ka qenë tek unë në zyrë ku jemi takuar, në këto raste këta persona lirohen nga taksat komunale, po ashtu qëllimi ynë është që ti ndihmojmë, se sa është në suaza ligjore dhe se si duhet që kjo punë të rregullohet me këtë do të mirët drejtorja e urbanizmit. Kërkesa e drejtorisë është që ju ta procedoni në kuvend dhe pastaj aty të mirët një vendim për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Flori Boshnjaku – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, falënderoj drejtorin që na ka sjellë këtë propozim vendim, do ti diskutoj disa çështje që në kuvend mos të kemi ankesa ndoshta edhe janë bërë lëshime. Sa i përket kërkesës së këtij personi mendoj se në i plotëson kriteret është mirë që ti dalim në ndihmë, ne të gjithë që jemi këtu e dimë se shumica e njerëzve i kanë të ndërtuara objektet e tyre dhe nuk kanë kurrfarë leje ndërtimi, ne nuk

pajtohem me këtë por ajo që është në suazat ligjore kishte me qenë mirë që ti ndihmohet. Tek pjesa hyrëse e propozim vendimit është mirë që të përmirësohet dhe të bëhet z. Latif Zena nga fshati Radostë, pastaj aty ku ceket destinimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore është mirë të ceket që bëhet për ndërtim të shtëpisë, në mënyrë që ne të kemi të qartë se për çka është duke e kërkuar këtë ridestinim. Pastaj tek neni 3 aty ku ceket: Kompensimi për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative të marrjes së lejes së ndërtimit sipas dispozitave të nenit 14, paragrafi 14.2, shkronja a dhe b të Udhëzimit Administrative Nr. 41/2006, për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore. Pra sipas këtij neni thuhet se duhet të paguhet, kurse me këtë material na është sjellë edhe një vendim ku ceket se personat e riatdhesuar janë të liruar nga pagesa, pra nëse lirohen atëherë ky nen duhet të hiqet. Pastaj tek neni 5 ku ceket se për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës përmes kësaj dhe kësaj drejtorie, por është mirë që drejtoritë të shkruhen komplet e jo me shkurtesa.

Rasim Fazliu – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, mendoj pak më ndryshe nga kolegët që diskutuan deri më tani, ne si anëtarë të KPF-së dhe anëtarë të Kuvendit Komunal ndoshta nuk është mirë që të legjitimojmë tokat bujqësore në toka ndërtimore sepse nëse e bëjmë besoj se kësaj kërkesë do të ketë pastaj më shumë në të ardhmen, ne duhet të shkojmë nga ajo që ti mbrojmë tokat bujqësore, sepse mjaftë i kemi mbushur me shtëpi dhe objekte tjera tokat. E kuptoj rastin dhe nuk dua të flas për rastin konkret, personin në fjalë as që e njoh, ndoshta e ka gjendjen e vështirë dhe është mirë që ti ndihmojmë, por flas në parim që ne si KPF dhe Kuvend nuk është mirë që të shkojmë nga ajo që tokat bujqësore të i shndërrojmë në toka ndërtimore. Drejtori e tha se është në kufi me zonën ndërtimore, prandaj ndoshta kishte me qenë më mirë që paraprakisht që ai të merë një parapëlqim nga MMPH, dhe atë pëlqim me na sjellë neve në Kuvend dhe pastaj ne të marrim vendime të caktuara sa i përket kësaj kërkesë, po ashtu kuvendi komunal nuk ka të drejtë të lëshojë pëlqime nga klasa e 1-4, por ka të drejtë nga klasa e 5,6 etj. jam pro që kjo pikë të kalojë për Kuvend dhe atje të diskutohet pak më gjerësisht sepse nuk jam që të kalojnë pikat do si do.

Fehmi Cena – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, kam disa vërejtjet e mija, sugjerimet e mija rreth kësaj kërkesë, nuk flas për këtë rast por flasë si dukuri, nuk jam kundër asaj që kjo pikë të kalojë për kuvend, por mendoj se duhet që të kemi kujdes në kësaj raste kur kemi nderim destinimi të tokës nga ajo bujqësore në atë ndërtimore, për arsye se komuna jonë është komunë bujqësore. Pastaj mendoj se qeveria komunale duhet që të ketë në strategji të punës së vetë edhe çështjen e mbrojtjes së tokës bujqësore sepse ajo është duke u uzurpuar gjithandej dhe ne duhet të jemi ata të cilët duhet që të mbrojmë këtë fenomen, jemi duke parë se çdo ditë janë duke u bërë ndërtime në toka bujqësore në mënyrë të egër dhe institucioni i cili duhet të ndalojë këtë është Komuna. Nuk e njoh rastin dhe nuk e njohë stacionin në teren se si është, por kishte me qenë mirë që të shikohet nëse ky person në fjalë ka mundësi që të ndërtojë shtëpinë brenda zonës ndërtimore, por nëse është e vetmja mundësi kjo ne duhet prapë të diskutojmë në kuvend. Këtu shkruan se janë vetëm 4 ari por ne e dimë sepse kemi shumë raste që ja fillojnë me nga 2 ari e pastaj vazhdojnë me ndërtime të tjera të cilat përfshijnë shumë hektar. Pastaj ne nëse i japim leje një rasti duhet ta dini që do të kemi pastaj edhe kërkesa për shumë raste të tjera ku pastaj fatkeqësisht ndërtohet një lagje dhe e gjithë ajo tokë bujqësore shndërrohet në tokë ndërtimore. I besoj kësaj shkresa ku ceket se kjo parcelë është e klasit të 3 dhe është skaj rrugës, por mendoj se skaj rrugë nga fshati Gexhe, Radostë e deri në Ratkoc nuk e besoj se ka tokë të klasit të 3, prandaj duhet që të kemi kujdes, pjesa më e madhe e kësaj toke në këtë pjesë është edhe në komasacion dhe kjo tokë është shumë e kushtueshëm dhe shumë e rëndësishme, prandaj ne duhet që ta mbrojmë maksimalisht këtë. Jam pro që të kalojë për kuvend kjo pikë por është mirë që edhe një herë të shqyrtohet nga drejtoria përkatëse.

Dervish Çadraku – Përsëritet për të gjithë të pranishmit, pajtohem plotësisht me parafolësit sa i takon ligjshmërisë dhe ndjeshmërisë së kësaj veprimtaria e cila kërkohet që të ndodhë, e dinë që kjo pjesë nuk është pjesë e urbanizuar sipas planit të Komunës së Rahovecit. Rasti i personit në fjalë është specifik dhe nuk është mirë që ne ta marrim tani këtë person si bazë për kufirin e lejueshmërisë apo të paligjshmërisë të ndërtimeve pa leje, drejtori e ceku se kjo parcelë është në pjesën kufitare, por unë po ju them që kjo parcelë është brenda pjesës së urbanizuar sepse përreth janë shtëpitë e ndërtuara. Pra mos të mendojemi tani ne të i mbrojmë këto 4 ari sepse siç thuhet “Buka shkon e pi mbrojmë troshat”, përkaj rrugës kemi plotë objekte të ndërtuara të cilat

zhvillojnë biznese, disa prej tyre edhe janë mbyllur dhe këto nuk kemi mundur të i ndalim, kurse tani një i riatdhësuar i cili është kthyer dhunshëm nga shtetet e jashtme dhe është po ashtu rast social ne duhet që ti ndihmojmë, gjithsesi se ne ligjshmërinë duhet ta përfillim por le ti japim të drejtën që drejtoria të mirët me këtë punë. Mendoj përderisa të tjerët janë duke i ndihmuar duhet që edhe ne si institucion të i dalim në ndihmë, pastaj këtu nuk ka ndonjë rrezik se do të ndërtohen edhe ndërtesat e tjera. Jam pro që kjo pikë të shkojë në kuvend, po ashtu jam pro që këtij njeriu të i dilet në ndihmë sepse ka pasur fatkeqësi të mëdha pa mare parasysh fajësinë apo pafajësinë.

Rumir Zhuniqi – Desha të bëjë një sqarim rreth asaj për marrje të pëlqimit nga MMPH, në konsultim me zyrën ligjore sipas ligjit thuhet: Së pari duhet që të merret vendimi paraprak nga ana e kuvendit të komunës, pastaj ky vendim shkon në shqyrtim në Ministrin e Bujqësisë, pastaj Ministria e bujqësisë del me një komision ku konstaton se ajo tokë a duhet që të i jepet ridestinimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore. Pra vendimi përfundimtar merret në Ministrin e Bujqësisë. Pastaj personi në fjalë nuk ka pronë tjetër këtë pronë siç e ceka më lartë e ka të falur nga vëllai, pastaj tjetra pse ne e kemi sjellë këtë kërkesë në kuvendë është se nëse personi në fjalë nuk pajiset me leje ndërtimore do ta humbë ndihmën që ju është ofruar nga ministria.

Rasim Fazliu – Nuk dua që të polemizoj por kolegut z. Dervish Çadraku dua ti them këtë: i nderuar ne jemi shumë të vetëdijshëm që jemi duke jetuar në Kosovë dhe shumica e shtëpive janë duke u ndërtuar pa leje në vende ku nuk duhet që të ndërtohen. Por mendoj se unë isha shumë i qartë së paku ne si organ legjislativ të mos bëjmë shkelje, pse të tjerët kanë bërë shkelje dhe kanë ngritur objekte aty ku nuk lejohet dhe ne me këtë të arsyetohemi se ata kanë ndërtuar të ndërtojmë edhe ne, pra me këtë nuk pajtohem. Po ashtu edhe me Drejtorin e Urbanizmit nuk pajtohem aspak, drejtori e tha se ligji e thotë kështu, por nuk është e vërtetë sepse ligji nuk e thotë, po ju citoj atë çka thotë ligji: Neni 6, pika 2 thotë: Ndërrimi i përhershëm i destinimit të tokës bujqësore të klasës së parë deri në klasën e katërt, do të bëhet me vendimin e kuvendit komunal pas marrjes së pëlqimit nga ministria. Po e them edhe një herë nuk jam kundër personit në fjalë edhe pse fare nuk e njohë, po ashtu i besoj z. Dervish Çadrakut të gjitha ato që i tha për këtë person, por ne nuk jemi fajtorë pse organet përkatëse nuk i kanë mbrojt këto toka bujqësore të mos shndërrohen në toka ndërtimore, por unë flas në parim.

Dervish Çadraku – Me të vërtetë kjo është sikurse me e gjete kimën në çervish, aty ka rrethe rreth shtëpia dhe ne jemi duke kërkuar ligjin, i nderuar ju e keni pas pushtetin disa vite dhe nuk keni qenë në gjendje me e bërë një plan urbanistik për komunën dhe tani je duke kërkuar ligj në pjesën ku ka shtëpi rrethe rreth, dhe personi dëshiron një shtëpi të vogël të ndërtojë dhe jo vetë por dikush tjetër që donë ti ndihmojë, kurse ti kërkon që ligji të përfillet. A e dini se sa shtëpi dhe pompa skaj rrugës janë ndërtuar dhe as që kanë pyetur dhe as që ke mundur me i ndalë, nuk po e them që ne tani të tregohemi të dobët, por pyetje ime është pse ne jemi duke u treguar të fortë tek ky i ligu, është mirë që të tregohemi të fortë tek ai që duet me qenë.

Nënkryetari – Pajtohem me të gjithë ju për ato komente që i dhatë, por me të vërtetë ky është një rast specifik, ky person është në një situatë goxha të rëndë si psikike, financiare ashtu edhe materiale, pra meqenëse është rast specifik ne e kemi sjellë këtë kërkesë në KPF dhe Kuvend. Vendimet preliminare zakonisht mirën në kuvendin e komunës dhe dërgohen në ministri përkatëse, ne si komunë këtij personi i kemi bërë zgjidhje përmes Ministrisë për Kthim dhe Komunitete si strehim, sigurim të ushqimit dhe veshmbathjeve për një vit, pra hapin e parë e kemi bërë. Por qëllimi i këtij ridestinimi është përfitimi i donacionit nga Ministria për Kthim dhe Komunitete për ndërtimin e n një shtëpie të vogël, ne kemi edhe sate të tjera ku Komuna ka një memorandum mirëkuptimi me IOM, ku do të ndërtohen diku rreth 3 shtëpi në Komunën e Rahovecit për komunitetin jo shumicë. Ne nuk bëjmë kurrfarë shkelje nëse marrim vendim si kuvend, sepse nëse është në kundërshtim me ligjin atëherë ministria përkatëse do na kthen vendimin si të paligjshëm.

Flori Boshnjaku – Po e merë edhe një herë fjalën sepse z. Rasim Fazliu e tha se prita të thotë diçka rreth kësaj znj. Florije, unë i dhashë propozimet e mija. Sa i përket këtij rasti ne juristët e themi se çdo rregull ka përjashtime, plotësisht pajtohem edhe me parafolësit se ne duhet që ti ndjekim procedurën ligjore sepse jemi organ vendimmarrës, por ne shumë herë me dashje apo pa dashje kemi bërë shkelje, edhe atëherë nuk jam pajtuar por as tani, por ne duhet që të mundohemi të gjithë së bashku dhe nëse ka mundësi që të merret pëlqimi

nga ministria përkatëse para mbledhjes së kuvendit le të mirët, nëse jo atëherë duhet që të shikojmë se cila është mundësia ligjore që ti dalim në ndihmë personit në fjalë.

Kryesuesi – E qes në votim propozim **Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore Nr. P-71510067-01271-9, Z.K- Radostë**, që të kalojë për kuvend për shqyrtim dhe aprovim: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

3. Informatë për Qarkoren e dytë Buxhetore 2019.

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, edhe pse nuk ka qenë praktik deri më tani që të jetë në kuvend informata e qarkores së dytë buxhetore, unë e kam parë të arsyeshme që të ju sjelli këtë informatë sepse në qarkoren e dytë buxhetore ka disa lëvizje të vogla dhe e kam ndier si obligim që edhe ju si anëtar të kuvendit të i keni këto informata. Pas qarkores së dytë buxhetore kam pasur një thirrje për konsultim me Ministrin e Financave në lidhje me shqetësimet tona në lidhje me qarkoren e parë buxhetore, po ashtu unë i kam adresuara edhe kërkesat dhe shqetësimet e juaja të cilat kanë dalë si rezultat në bazë të qarkores së parë buxhetore. Në këtë takim kam kërkuar që të ritet kategoria a mallrave dhe shërbimeve, si rezultat i keq klasifikimit që na ka qitur auditori, po ashtu kam kërkuar që të ritet edhe kategoria e subvencioneve, me theks të veçantë orientim e kam pasur rritja e subvencioneve në bujqësi, këtu ka pasur një rritje por kjo rritje ka qenë simbolike dhe realisht as për së afërmi nuk i plotëson nevojat. Të gjitha këto ndryshime bëhen në kuadër të buxhetit total dhe këto lëvizje bëhen kryesisht nga kategoria e investimeve kapitale. Tash si rezultat i kësaj kemi këto ndryshime: Kategoria e pagave dhe e mëditjeve është rritur për 44,140.00 €, kategoria e mallrave dhe e shërbimeve për 104,627.00 € që realisht për vitin 2019 me këto lëvizje ne nuk do të kemi keq klasifikim të shpenzimeve. Kurse subvencionet janë rritur për 53,350.00 €. Këto rritje janë bërë në kuadër të adresimit të një kërkesë që ne e kemi bërë për punëtorët në shëndetësi, ku realisht sipas formulës buxhetore ne kemi qenë të dëmtuar dhe si rezultat i presionit ata na kanë rritur edhe 8 punëtor në shëndetësi dhe 1 në arsim, prandaj edhe kategoria për paga është ngritur për 44,140.00 €. Gjithmonë flasë në raporte me qarkoren e parë buxhetore.

Dervish Çadraku – Falënderoj drejtorin që e ka ndarë këtë informatë me ne, por nuk besoj se kemi nevojë që të debatojmë rreth kësaj informate sepse nuk varet nga ne dhe ne nuk e ndryshojmë këtë gjendje.

Florije Boshnjaku – Falënderoj drejtorin që na ka sjellë këtë informatë sa i përket qarkores së dytë buxhetore, pajtohem me parafolësin që ne nuk mundemi që të ndryshojmë këtë qarkore, por desha disa sqarime sepse nuk i kam të qarta disa gjëra. Në faqe nr. 2 ku ceket se në kategorinë e shpenzimeve paga dhe mëditje rritja është dedikuar për arsimin para universitar në veçanti, dhe rrjedhë nga aprovimi i politikave të reja nga komisioni i granteve, gjegjësisht asistencë për fëmijë me nevojë të veçantë, dhe pagesa e tre pagave pas pensionimit. Pyetje ime është kjo q vlen vetëm për mësimdhënës apo vlen për të gjithë punëtorët të cilët marrin pagë nga buxheti i Republikës së Kosovës. Pastaj në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve e ke të cekur se mbulimin e nevojave të financimit për menaxhimin e mbeturinave, kam pyetur edhe më parë dhe prapë po pyes as ke informatë, a duhet ne që ti ndajmë mjetet për mbledhje të mbeturinave apo jo, dhe pse thuhet këtu se rritja është dedikuar për mbeturina. Pastaj më poshtë ceket se fondet e huamarrjes në shëndetësi dhe arsim janë shpërndarë nëpër komuna të caktuara sipas planit të dorëzuar nga ministrinë e linjës, pyetje ime është a kemi përfituar ne nga kjo huamarrje, qoftë në shëndetësi apo arsim, apo pritet që në vitin e ardhshëm që të përfitojmë. Pyetje tjetër është drejtor nëse hynë në fuqi ligji mbi paga a do të ndahet buxhet shtesë apo kemi buxhet të mjaftueshëm. Dhe në fund të faqes nr. 3 ceket Buxheti i përgjithshëm gjinor, komuna duhet të adresojnë buxhetimin e përgjithshëm gjinorë sipas udhëzimeve të dhëna me Qarkoren buxhetore 2019/01. A do të kemi buxhet të veçantë për këtë kategori apo si do të bëhet.

Rasim Fazliu – Falënderoj drejtorin që na ka sjellë qarkoren e dytë buxhetore, i përshëndes ndryshimet të cilat janë bërë sepse i kemi pasur disa rekomandime nga auditori për vitin e kaluar që janë bërë disa shpenzime jashtë linjave buxhetore. Kurse tani është bërë një punë e mirë ku është rritur kategoria e mallrave dhe e shërbimeve, tani shpenzimet e varrimit janë legjitime dhe besoj se më nuk do të kemi vërejtje nga auditori i përgjithshëm. Po ashtu është bërë mirë tani që pas pensionimit mësimdhënësit do të paguhet 3 paga shtesë, por pyetja ime për drejtorin e DKA-së ose për nënkryetarin është: a e dini se sa mësimdhënës janë në pritje të marrjes së këtyre 3 pagave.

Fehmi Cena – Desha një sqarim, ne jemi duke dëgjuar se nga niveli qendror po thuhet se për vitin e ardhshëm do të ketë ngritje të pagës, qoftë përmes ngritjes direkët ose përmes ngritjes së koeficientit, desha të ju pyes si qëndron gjendja, nëse ne kemi këtë buxhet fiks, në duket se nuk përputhet me atë që është duke u thënë. Pyetja ime është: A do të ketë ngritje apo jo sepse punëtorët e arsimit dhe të shëndetësisë janë duke pritur që të ketë ngritje të pagave.

Afrim Limani – Po ja nisi me përgjigje nga znj. Florije Boshnjaku, pyetje e parë ishte sa i përket qarkores buxhetore, e nderuar kjo qarkore kuptohet se është në nivel të Republikës së Kosovës, dhe kjo ka ardhur si rezultat i komisionit të grandëve, komisioni i grandëve caktohet në bazë të 3 komunave ku prej aty pastaj dalin kërkesat të cilat i kanë adresuar edhe komunat. Ky komision aty ka vendosur se në qarkoren e dytë buxhetore të bëhen këto ndryshime, si pagesa e tre pagave pas pensionimit për mësimdhënës, dhe kjo ka dalë si rezultat i kërkesës së Komunës së Rahovecit, pra kërkesës sonë ja kanë parë hairin edhe komunat e tjera të Republikës së Kosovës. Në buxhet në pozicionin e pagave kjo kategori nuk ka qenë e planifikuar dhe ne vazhdimisht jemi ballafaquar me gjykata, ku përmbaruesi i ka marrë mjetet ku ka dashur dhe nuk na ka pyetur fare neve, ne kemi pasur shumë probleme sepse me ligj kanë të drejtë marrje të këtyre pagave pas pensionimit atëherë pse mos të jetë në linja buxhetore, tash e tutje pagesa jubilarë prej tre pagave është në buxhet e planifikuar. Ne për Komunën tonë i kemi dërguar saktë numrin e punëtorëve që do dalin në pension për vitin 2019,2020,2021. Pyetje tjetër ishte sa i përket mbulimit në nevojave për mbeturina, për komunën tonë nuk ka kurse për komunat tjera nuk kamë ndonjë informatë, unë i kam adresuar edhe disa kërkesa të tjera ku besoj se do të prodhojnë rezultat. Pyetje e radhës ishte sa i përket fondit të huamarrjes, ne fondet e huamarrjes i kemi aktualisht edhe për vitin 2018 si në arsim dhe shëndetësi, në shëndetësi i kemi 134,000.00 € që realisht ende nuk janë alukuar këto mjete dhe DKA-ja i ka diku rreth 34,000.00 €, pra huamarrja është planifikuar edhe për vitin e ardhshëm. doktori e pyeti një pyetje sa i përket ligjit për paga, doktor a do të ketë rritje të pagave apo ndryshim të koeficientit e gjitha varet nga katalogu dhe ligji i pagave që pritet të aprovohet në muajin shtator, sipas disa informatave që i kam, pra kjo varet se si do të vendos Kuvendi i republikës së Kosovës, por ka indikacione të mira se do të bëhet mirë. Tek buxheti gjinorë e nderuara znj. Florije kjo pyetje mua shpesh herë më bënë edhe nervoz, ministria e financave ka kërkuar një statistikë të saktë që të shihet se sa është përfaqësimi i gjinisë femërore në buxhetin e komunës së Rahovecit. Ne e kemi kryer këtë punë dhe ju kemi dërguar atyre, por nuk e di pse ministria e financave nuk e ndanë një buxhet të veçantë për gjininë femërore.

Fehmi Cena – Desha një sqarim shtesë drejtor rreth kësaj që u tha se do të jepen 3 paga shtesë pas pensionimit, këtu nuk ceket qartë që është vetëm për punëtorët e arsimit dhe unë për herë të parë jam duke e dëgjuar që është vetëm për punëtorë të arsimit, mendoj se shumica mendojnë se është edhe për shëndetësi sepse sa e di unë arsimit dhe shëndetësia i takojnë një kategori janë shërbyes publik, dhe ai i cili e ka bërë këtë ka bërë diskriminim sepse njërës kategori me i dhen dhe tjetrës jo nuk është në rregull. Nuk e di se çfarë kriteri kanë përdorur kur kanë diskutuar rreth kësaj çështje, por unë si një këshilltar i thjeshtë që jam dhe mjek me profesion mendoj se kjo që është bërë nuk është në rregull, nëse nga shteti jepen 3 paga pas pensionimit atëherë kjo duhet të jetë për të gjithë shërbyesit publikë, jam kundër kësaj dhe jam pro asaj ose të i jepet të gjithëve ose askujt.

Afrim Limani – Drejtor ju e ngritët një shqetësim që konsideroj është shumë me vend edhe unë plotësisht pajtohem me shqetësimin tuaj. Pagesa për 3 paga shtesë për mësimdhënës është e specifikuar në qarkoren e parë buxhetore dhe në qarkoren e dytë buxhetore, e thash më parë se kjo ka ardhur si rezultat i komisionit të grandëve nga Ministria e Financave. Tre paga jubilarë pas pensionimit janë vetëm për arsim, ndërsa për punëtorët e administratës dhe shëndetësi nuk është, e di se me ligje edhe administrata edhe shëndetësia kanë të drejtë për 3 paga shtesë pas pensionimit, neve na mbetet ende që të ballafaqohemi me përmbarues. Shpresoj se ndoshta me rishikim të buxhetit do të merren parasysh edhe këto kërkesa shtesë sepse është detyrim me ligj.

Fehmi Cena – Kisha dashur që kjo të precizohet, nëse është me ligj atëherë vlen, kishte me qenë mirë të na tregoni se cili është ai ligj në mënyrë që ta shikojmë edhe ne dhe të themi fjalën tonë, edhe pse ligjet i bënë Kuvendi i republikës së Kosovës.

Afrim Limani – i nderuari doktor ne si komunë nuk mundemi në rishikim të buxhetit të ndryshojmë diçka sepse kjo bëhet nga niveli qendror, MF është ajo e cila i rregullon këto gjëra, prandaj e thash se duke ditur se është një

obligim ligjor shpresoj se me rishikim të buxhetit do të përfshihet edhe ajo që e diskutuam deri më tani. Unë së bashku me avokatin e komunës e kemi shikuar ligjin se a kanë të drejtë edhe punëtorët e tjerë që të përfitojnë 3 paga pas pensionimit dhe e pamë që me ligje kishin të drejtë edhe punëtorët e tjerë.

Floriqe Boshnjaku – Të nderuar ne si kuvend kemi përfaqësues në Asociacionin e Komunave të Republikës së Kosovës dhe është mirë këta përfaqësues atje ta e ngrisin këtë shqetësim, asociacioni i Republikës së Kosovës këtë funksion e ka.


Kryesuesi – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e bërë. Kalojmë në pikën e fundit:

4. Të ndryshme.

Të nderuar anëtar të KPF, desha të ju informojë se do të kemi edhe një pikë shtesë për Kuvend, ajo është Rregullorja për shërbime komunale, kuvendi duhet që ti jepe leje për procedim të mëtutjeshëm për dalje në debat publik. A ka dikush të shtoj edhe diçka sa i përket pikës së fundit, nëse jo atëherë të nderuar anëtar të KPF-së ju falënderoj për kontributin e dhënë, shihemi në takimet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në ora: 11:10

Procesmbajtësi


Skender Hamza

